



# Strukturat akomoduese 2021

Gjatë vitit 2021, treguesit e shfrytëzimit të kapaciteteve të strukturave akomoduese, paraqiten si më poshtë: Numri i vizitorëve gjithsej është rritur me 84,9 %, në krahasim me vitin 2020. Rritje kanë pasur dhe dy treguesit e mëposhtëm:

- numri i vizitorëve rezident është rritur me 46,8 %;
- numri i vizitorëve jo-rezident është rritur me 2,3 herë më shumë;

Përshkrimi	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20	Total	I - 21	II - 21	III - 21	IV - 21	Total
<b>Numri i vizitorëve gjithsej</b>	110,251	68,234	372,301	114,394	665,180	117,210	266,479	630,175	216,401	1,230,265
<b>Numri i vizitorëve rezident</b>	60,134	52,348	190,931	68,110	<b>371,523</b>	66,210	125,561	240,711	112,993	<b>545,475</b>
<b>Numri i vizitorëve jo-rezident</b>	50,117	15,886	181,370	46,284	<b>293,657</b>	51,000	140,918	389,464	103,408	<b>684,790</b>

Burimi INSTAT: Numri i vizitorëve rezident dhe jo-rezident, tremujore

Numri i netë qëndrimeve për 2021 është rritur me 98,4 %, në krahasim me vitin 2020. Rritje kanë pasur edhe dy treguesit e mëposhtëm:

- numri i netë qëndrimeve nga rezident është rritur me 44,3 %;
- numri i netë qëndrimeve nga jo-rezident është rritur me 2,5 herë;

Përshkrimi	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20	Total	I - 21	II - 21	III - 21	IV - 21	Total
<b>Numri i netë qëndrimeve</b>	177,356	142,611	1,094,015	191,462	1,605,444	164,999	553,703	2,060,326	405,928	3,184,956
<b>Numri i netë qëndrimeve rezident</b>	106,164	109,633	484,185	100,046	<b>800,028</b>	88,789	232,662	664,172	168,943	<b>1,154,566</b>

<b>Numri i netë qëndrimeve jo-rezident</b>	71,192	32,978	609,830	91,416	<b>805,416</b>	76,210	321,041	1,396,154	236,985	<b>2,030,390</b>
--	--------	--------	---------	--------	----------------	--------	---------	-----------	---------	------------------

Burimi INSTAT: Numri i netë qëndrimeve rezident dhe jo-rezident, tremujore

## VIZITORE

Gjatë vitit 2021, është shënuar rritje e numrit të vizitorëve me 84,9 %, krahasuar me vitin 2020. Në **zonat bregdetare** rritja vjetore është në masën 87 % krahasuar me vitin 2020. Ndërsa për nga **lloji i struktues** është e dallueshme që numri më i madh i vizitorëve preferojnë **hotele dhe akomodime të ngjashme**. Kundrejt totalit vihet re se

- numri më i madh i vizitorëve sipas rajoneve është në "Rajonin Qendër" (37,2%);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin në "Zonat bregdetare" (59,3 %);
- sipas llojit të strukturave akomoduese në "Hotele dhe akomodime të ngjashme" (98 %);

Më poshtë gjeni të dhënat e vizitorëve në tre vitet e fundit të ndarë sips **rajoneve**; zonës së afërsisë me bregdetin; dhe sipas llojit të strukturës akomoduese:

	Vizitorët 2019	Vizitorët 2020	Vizitorët 2021	Krahasimi në %
<b>TOTALI I VIZITORËVE</b>	<b>1,253,496</b>	<b>665,180</b>	<b>1,230,265</b>	<b>85.0</b>
<b>RAJONET</b>				
<b>Rajonet e Veriut</b>	327.752	128,178	328,030	155.9
<b>Rajoni Qëndër</b>	459.774	245,508	458,645	86.8

<b>Rajoni I Jugut</b>	465,970	291,494	443,590	52.2
<b>ZONA E AFËRSISË ME BREGDETIN</b>				
<b>Zonë Bregdetare</b>	570,971	390,006	729,177	87.0
<b>Zonë Jo-bregdetare</b>	682,525	352,242	501,088	42.3
<b>PËRSHKRIMI I LLOJIT TË STRUKTURËS AKOMODUESE</b>				
<b>Hotele dhe akomodime të ngjashme</b>	1,165,853	630,344	1,173,153	86.1
<b>Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra</b>	72,614	29,151	49,497	69.8
<b>Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra , ose ruloa argëtimi</b>	15,029	5,685	7,291	28.2

Më poshtë po jepet numri i vizitorëve sipas tremujorëve dhe me ndarjen vizitorë resident dhe jorezident për vitin 2021, nga ku rezulton se numri i vizitorëve jorezidentë është më i madh se i rezidentëve:

	Rezident					Jorezident				
	Tr.I - 21	Tr.II - 21	Tr.III - 21	Tr.IV - 21	Totali	Tr.I - 21	Tr.II - 21	Tr.III - 21	Tr.IV - 21	Totali
<b>RAJONET</b>										
<b>Rajonet e Veriut</b>	17,092	29,444	50,629	26,288	<b>123,453</b>	8,752	38,729	138,296	18,800	<b>204,577</b>
<b>Rajoni Qëndër</b>	22,968	40,293	42,383	38,007	<b>143,651</b>	36,581	74,534	133,818	70,061	<b>314,994</b>
<b>Rajoni I Jugut</b>	26,150	55,824	147,699	48,698	<b>278,371</b>	5,667	27,655	117,350	14,547	<b>165,219</b>
<b>ZONA E AFËRSISË ME BREGDETIN</b>										
<b>Zonë Bregdetare</b>	19,531	69,062	155,143	33,936	<b>277,672</b>	21,988	99,920	290,969	38,628	<b>451,505</b>
<b>Zonë Jo-bregdetare</b>	46,679	56,499	85,568	79,057	<b>267,803</b>	29,012	40,998	98,495	64,780	<b>233,285</b>
<b>PËRSHKRIMI I LLOJIT TË STRUKTURËS AKOMODUESE</b>										
<b>Hotele dhe akomodime të ngjashme</b>	63,549	119,816	224,840	108,449	<b>516,654</b>	50,533	136,608	368,135	101,223	<b>656,499</b>
<b>Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra</b>	2,247	5,044	13,270	3,942	<b>24,503</b>	467	3,954	18,747	1,826	<b>24,994</b>
<b>Hapësirat për kamping për parqe, për çadra ose rulot argëtimi</b>	414	701	2,601	602	<b>4,318</b>	-	356	2,582	35	<b>2,973</b>

## NETË QËNDRIME

Gjatë viti 2021 numri i netë qëndrimeve të deklaruara është rritur 2.1 herë më shumë se viti 2020.

Në **zonat jo bregdetare** rritja vjetore e netëqëndrimeve është në masën 135 % krahasuar me vitin 2020. Ndërsa për nga **lloji I struktues** është e dallueshme që numri më i madh i netëqëndrimeve është në **hotele dhe akomodime të ngjashme**. Kundrejt totalit për vitin 2021 vihet re se:

- numri më i madh i netëqëndrimeve sipas rajoneve është në "Rajonin e jugut" (38 %);
- sipas zonave të afërsisë me bregdetin në "Zonat bregdetare" (75%);
- sipas llojit të strukturave akomoduese në "Hotele dhe akomodime të ngjashme" (94,8 %);

Më poshtë gjeni netëqëndrimet në tre vitet e fundit të ndarë sipas **rajoneve; zonës së afërsisë me bregdetin;** dhe sipas **llojit të strukturës akomoduese:**

RAJONET	Netëqëndrimet 2019	Netëqëndrimet 2020	Netëqëndrimet 2021	Ndryshimi në %
<b>Totali</b>	<b>3,253,419</b>	<b>1,504,216</b>	<b>3,175,203</b>	<b>2,1 herë më shumë</b>
<b>Rajonet e Veriut</b>	1,078,360	461,800	824,644	78.6
<b>Rajoni Qëndër</b>	1,076,512	387,375	1,145,547	195.7
<b>Rajoni I Jugut</b>	1,098,547	655,041	1,205,012	84.0

<b>ZONA E AFËRSISË ME BREGDETIN</b>				
<b>Zonë Bregdetare</b>	1,913,448	1,068,965	2,380,694	122.7
<b>Zonë Jo-bregdetare</b>	1,339,971	342,240	804,262	135.0
<b>PËRSHKRIMI I LLOJIT TË STRUKTURËS AKOMODUESE</b>				
<b>Hotele dhe akomodime të ngjashme</b>	3,002,289	1,478,022	3,008,704	103.6
<b>Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra</b>	221,669	115,957	149,278	28.7
<b>Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ,rulo etj</b>	29,461	11,465	19,146	67.0

Siç shihet rritjen më të madhe e kanë netëqëndrimet në “Rajonin Qëndër”, krahasuar me vitin paraardhës, por kundrejt totalit “Rajoni I jugut” është më i preferuari për të qëndruar. Në lidhje me netëqëndrimet sipas afërsisë me bregdetin, vihet re që rritjen më të madhe krahasuar me vitin paraardhës e kanë netëqëndrimi në “Zonat Jo-bregdetare”, por kundrejt totalit vlera më e lartë arrihet nga netëqëndrimet në “Zonat bregdetare” për vitin 2021.

Më poshtë po japim një tabelë më të hollësishme për netëqëndrimet e viti 2021 me tremujorë dhe për vizitorë të ndarë në rezidentë dhe jo rezidentë:

	Rezident					Jorezident				
	Tr.I - 21	Tr.II - 21	Tr.III - 21	Tr.IV - 21	Totali	Tr.I 21	Tr.II - 21	Tr.III - 21	Tr.IV - 21	Totali
<b>RAJONET</b>										
<b>Rajonet e Veriut</b>	21,513	47,525	127,523	36,933	233,494	11,599	67,565	471,952	40,034	591,150
<b>Rajoni Qëndër</b>	31,066	72,439	89,372	62,098	254,975	54,848	176,286	497,297	162,141	890,572
<b>Rajoni I Jugut</b>	36,210	112,698	447,277	69,912	666,097	9,763	77,190	426,905	34,810	538,915
<b>ZONA E AFËRSISË ME BREGDETIN</b>										
<b>Zonë Bregdetare</b>	28,312	152,359	528,961	67,536	777,168	34,429	245,810	1,202,880	120,407	1,603,526
<b>Zonë Jo-bregdetare</b>	60,477	80,303	135,211	101,407	377,398	41,781	75,231	193,274	116,578	426,864
<b>PËRSHKRIMI I LLOJIT TË STRUKTURËS AKOMODUESE</b>										
<b>Hotele dhe akomodime të ngjashme</b>	84,544	218,036	613,692	160,336	1,076,608	75,280	308,212	1,316,566	232,038	1,932,096
<b>Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra</b>	3,593	13,555	43,414	7,836	60,570	930	12,202	71,314	4,262	88,708



Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	652	1,071	7,066	771	9,560	-	627	8,274	685	9,586
---	-----	-------	-------	-----	-------	---	-----	-------	-----	-------

## Metodologjia

### Informacion mbi vrojtimin:

INSTAT llogarit dhe publikon treguesit tremujorë të statistikave të akomodimit që përbejnë ofertën turistike në vend.

Qëllimi i vrojtimit mbi strukturat akomoduese është të monitorojë aktivitetet turistike, të llogarisë treguesit statistikor mbi ofertën akomoduese të turizmit shqiptar, që janë të rëndësishëm për të përcaktuar tendencën e zhvillimit të kapaciteve të sektorit të turizmit. Të dhënat mbledhen çdo muaj nëpërmjet pyetsorit "Anketa e Strukturave Akomoduese".

### Fusha e mbulimit

Në anketën e strukturave akomoduese përfshihen të gjitha strukturat akomoduese turistike nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të vitit 2018. Strukturat akomoduese turistike klasifikohen dhe përshkruhen në grupe sipas klasifikimit NVE Rev. 2 si vijon:

- Hotele dhe akomodime të ngjashme. Kjo klasë përfshin: hotele, resort hotelier (kompleks turistik), hotel suita/apartament, motele.
- Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra. Kjo klasë përfshin: shtëpi pushimi për fëmijë dhe të tjerë, apartamente dhe shtëpi njëkatëshe për vizitorë, shtëpi pushimi familjare pa shërbim në dhomë, bujtina të rinjsh dhe streha malore.
- Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi. Kjo klasë përfshin kampingje e parqe për çadra, automjete ose rulota për vizitorët me qëndrim të shkurtër.

**Strukturat akomoduese dhe vizitorët e pa regjistruar nuk janë subjekt i këtij studimi.**

Treguesit që mblidhen nga anketa përfshijnë:

- Numri i vizitorëve rezident;
- Numri i vizitorëve jo – rezident;
- Netët e qëndrimit nga vizitorët rezident;
- Netët e qëndrimit nga vizitorët jo – rezident;

Mbledhja e këtyre treguesve dhe llogaritja e niveleve të kapacitetit dhe shfrytëzimit realizohen në bazuar në Aneksin I “Oferta turistike-Statistikat e Akomodimit” të Rregullores së Bashkimit Europian (EU) no. 692/2011.

**Struktura akomoduese** në statistikën e akomodimit përfshin të gjitha institucionet e akomodimit turistik që ofrojnë, si një shërbim të paguar (çmimi mund të subvencionohet pjesërisht ose plotësisht), shërbime akomodimi afatshkurtra ose qëndrimi të shkurtër.

**Dhomë fjetje:** në një strukturë akomodimi apo banesë është njësi e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme).

**Shtrat:** numri i shtretërve në një godinë akomodimi turistik përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përjashtuar shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.

**Vizitorë:** një vizitorë është përcaktuar si një person i cili qëndron të paktën një natë në hotel duke përfshirë edhe fëmijët.

**Rezident:** konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

**Jo-Rezident:** konsiderohet ai person që nuk ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

**Netë qëndrimi:** Një natë qëndrimi është çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) aktualisht shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi

Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, i cili është një klasifikim i unifikuar dhe përdoret si bazë për mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave Rajonale Evropiane. Informacioni më poshtë përfshin se cilat prefektura janë në rajonin e Veriut, Qendrës dhe Jugut.

**Rajoni i Veriut:** Dibër; Durrës; Kukës; Lezhë; Shkodër

**Rajoni Qendër:** Elbasan; Tiranë

**Rajoni i Jugut:** Berat; Fier; Gjirokastrë; Korçë; Vlorë

**Zonat bregdetare** janë Njësi Administrative Vendore (LAU) që janë në kufi ose afër një vije bregdetare. Zonat bregdetare klasifikohen sipas dy kategorive të mëposhtme: Zonat bregdetare: LAU që kufizohen me vijën bregdetare ose LAU që kanë të paktën 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare;

• **Zonat jo-bregdetare:** LAU që nuk janë "zona bregdetare"; që nënkupton LAU që nuk kufizohen me vijën bregdetare dhe kanë më pak se 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare